

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8335
E shtunë, 4 korrik 2026
Çmimi 0.50 €

FSK-së i shtohen edhe 12 kadetë të rinj

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

RAMA: DORËHEQJA NUK ËSHTË OPSION, MISIONI YNË ËSHTË ANËTARËSIMI NË BE

FAQE 4-5



Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka folur për zhvillimet e fundit në vend, veçanërisht për protestat, duke theksuar se në Shqipëri nuk është thyer besimi. "Në Shqipëri ekziston një shembull i bukur i lirisë dhe i demokracisë në veprim, një bulevard që u përket njerëzve nga të

gjitha sferat e jetës, të cilët kanë pikëpamjet e tyre dhe duan që zëri i tyre të dëgjohet", ka deklaruar Rama në një intervistë për Deutsche Welle (DW). Ai theksoi se dorëheqja e tij nuk ka qenë, nuk është dhe nuk do të jetë një opsion. Rama u shpreh se ai dhe Partia Socialiste janë

mandatuar nga 868 mijë qytetarë shqiptarë për të përmbushur misionin e mbylljes së negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. "Ky është një mision historik që nuk mund të lihet në gjysmë për asnjë arsye", ka thënë Rama

PAGA MINIMALE 500 EURO: KUSH FITON, KUSH HUMB?

F. 3



EKREM BAJROVIQ DËNOHET ME 12 VJET BURGIM NË RIGJYKIM PËR KRIME LUFTE NË KOSOVË

F. 3



AKTUALE



PRESIDENCA E IRLANDËS NË BE: EKONOMIA DHE UKRAINA NË FOKUS

F. 2

SHQIPËRIA RENDITET E 43-TA NË BOTË PËR FUQINË E PASAPORTËS

F. 3

GASHI: ÇDO QYTETAR DO TA KETË MJEKUN E VET FAMILJAR NË PRISHTINË

F. 7

EKONOMI



OEK-u DHE RIINVEST: KOSOVA DUHET TË PËRFSHIHET NË RRJETIN RAJONAL TË GAZIT PËR TË FORCUAR SIGURINË ENERGETIKE

F. 8

KAPEN 23,500 EURO TË PADEKLARUARA NË PIKËN KUFITARE MERDARË

F. 8

SPORT



FFK-ja FTON FUTBOLLISTËT NGA DIASPORA TË STËRVITEN NË KAMPIN NACIONAL NË HAJVALI

F. 11

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçishtë-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mok: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
838 500 878 | 045 500 878
844 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Peshko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

PRESIDENCA E IRLANDËS NË BE: EKONOMIA DHE UKRAINA NË FOKUS

Irlanda drejton për gjashtë muaj presidencën e radhës të BE-së. Vendi ka përpara sfida të mëdha: Në radhë të parë bëhet fjalë për para

BRUKSEL, 3 KORRIK - Irlanda, në skajin e Oqeanit Atlantik dhe megjithatë thellësisht evropiane - kështu e përshkruan vendin e tij kryeministri irlandez Micheál Martin. Kjo është hera e tetë që nga anëtarësimi në vitin 1973 që Irlanda mban Presidencën e radhës së Këshillit të Bashkimit Evropian nga 1 korriku.

Kryeministri Micheál Martin theksoi gjatë ceremonisë së hapjes në Dublin se irlandezët i detyrohen shumë anëtarësimin të tyre në BE. Sipas tij, shndërrimi i Irlandës në një ekonomi dhe shoqëri moderne e të hapur është i lidhur ngushtë me anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Kur u nënshkrua akti i anëtarësimin në vitin 1972, të ardhurat mesatare në vend ishin pak më pak se dy të tretat e mesatares evropiane. Në atë kohë ishte ende në fuqi një ligj që ua ndalonte grave të ushtronin profesionin në sektorin publik pas martesës, ndërsa ishulli po përjetonte vitin më të rëndë të trazirave në Irlandën e Veriut, kujtoi Martin të mërkurën.

Që atëherë, vendi ka përjetuar një zhvillim të vrullshëm ekonomik, duke fituar nofkën "Tigri Keltik". Që nga viti 2018, Irlanda është një nga kontribuuesit neto në BE, që do të thotë se paguan më shumë në buxhetin e BE-së sesa merr prej tij. Me pak më shumë se pesë milionë banorë, Irlanda ka - pas Luksemburgut - Prodhimin e Brendshëm Bruto për frymë të dytin më të lartë në Bashkimin Evropian.

Irlanda mbështetet të "forca në unitet"

Gjatë gjashtë muajve të ardhshëm, Irlanda do të

drejtë mbledhjet e Këshillit të BE-së - organit legjislativ të Bashkimit Evropian ku përfaqësohen 27 shtetet anëtare. Motoja e saj në gjuhën irlandeze është: "Ní neart go cur le chéile", një shprehje që nënkupton se nuk ka forcë pa unitet.

Detyra e qeverisë irlandeze do të jetë të ruajë dhe forcojë këtë unitet mes 27 shteteve anëtare. Irlanda synon të lërë gjurmë veçanërisht në fushat e konkurrueshmërisë, mbrojtjes së vlerave të BE-së dhe sigurisë.

Në krye të listës së prioritetëve janë: ndalimi i përdorimit të rrjeteve sociale për të rinjtë nën moshën 16 vjeç, avancimi i diskutimeve për buxhetin e BE-së pas vitit 2028 dhe nxitja e Bashkimit të Tregjeve të Kapitalit. Gjithashtu,

mbështetja për Ukrainën mbetet një nga objektivat kryesore të presidencës irlandeze.

Zelensky si mysafir nderi në Dublin

Si shenjë e veçantë solidariteti, presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky u ftua në ceremoninë e hapjes në Dublin. Ai e shfrytëzoi këtë rast për të kërkuar sanksione të mëtejshme kundër Rusisë. Sipas tij, nevojiten masa kundër të ashtuquajturës "flotë në hije" ruse dhe kundër "shumë mjeteve të tjera" mbi të cilat mbështetet presidenti rus Vladimir Putin për të vazhduar luftën.

Zelensky theksoi se në këtë kategori përfshihen edhe kompani në Evropë, që sipas tij ekzistojnë vetëm për të punuar për Rusinë dhe që vazhdojnë ta furnizojnë agresorin rus me materiale të nevojshme.

Në Dublin mesazhi u kuptua



qartë. Javët e fundit kishin shkaktuar debat eksportet e oksidit të aluminit nga Irlanda drejt Rusisë, një material me rëndësi të madhe edhe për industrinë ushtarake.

Kryeministri Martin deklaroi në një konferencë të përbashkët për shtyp me Zelenskyn se çështja ishte diskutuar në mënyrë dypalëshe. Një hetim do të përfundojë në javët e ardhshme dhe rezultatet do t'i paraqiten Komisionit Evropian. Irlanda nuk dëshiron që materiale me origjinë irlandeze të mbështesin makinerinë ushtarake ruse. Përveç kësaj, qeveria irlandeze synon të punojë për sanksione të tjera kundër Rusisë. Aktualisht po zhvillohen negociata në Këshillin e BE-së për paketën e 21-të të sanksioneve, ndërsa Irlanda dëshiron të avancojë edhe një paketë të 22-të. Ajo gjithashtu do të përpiqet të hapë kapituj të tjerë negociues për

anëtarësimin e Ukrainës në BE.

Irlanda dëshiron rezultate në konkurrencë

Për të forcur konkurrueshmërinë, qeveria irlandeze synon të avancojë strategjinë e BE-së "Një Evropë, një treg". Nën këtë slogan, Bashkimi Evropian ka vendosur si objektiv përfundimin e tregut të përbashkët deri në fund të vitit 2027 dhe thjeshtimin e kushteve për bizneset, për shembull përmes uljes së burokracisë, përfundimit të Bashkimit të Tregjeve të Kapitalit dhe krijimit të një forme të unifikuar juridike të kompanive në nivel evropian. Ministri irlandez i Financave, Simon Harris, deklaroi se ky projekt do të jetë fokusi i tij kryesor, pasi deri në fund të vitit duhet të arrihet një marrëveshje politike. Priten

negociata shumë të vështira për buxhetin trilionësh.

Deri në fund të vitit synohet gjithashtu arritja e një marrëveshjeje politike për buxhetin e ardhshëm të BE-së. Sipas Micheál Martin, pozicionet aktuale të shteteve anëtare, të cilat mbulojnë pjesën më të madhe të buxhetit me kontributet e tyre, janë ende shumë larg njëra-tjetrës.

Buxheti duhet të finalizohet deri në fund të vitit 2027, pasi do të mbulojë periudhën 2028-2035. Për arsye politike, siç janë zgjedhjet e ardhshme në Francë, në Bruksel ekziston një konsensus i gjerë që negociatat të përfundojnë brenda këtij viti. Një takim i posaçëm i kreut të shteteve dhe qeverive është planifikuar për në nëntor.

Një aspekt që institucionet evropiane dhe shtetet e tjera do ta ndjekin nga afër gjatë presidencës irlandeze është qëndrimi i Irlandës ndaj rregullimit të sektorit të teknologjisë, veçanërisht në debatet për sovranitetin teknologjik evropian dhe për një taksë të mundshme digjitale.

Në Irlandë janë të vendosura kompani të mëdha amerikane si Google, Apple dhe Meta, të cilat përfitojnë nga normat relativisht të ulëta tatimore. Ministri i Financave, Simon Harris, theksoi se Irlanda do ta luajë rolin e saj si një "ndërmjetës i ndershëm".

Ai nënvizoi se Irlanda ka qëndrime shumë të qarta kur bëhet fjalë për rregullimin e gjigantëve teknologjikë. Megjithatë, sipas tij, duhet të sigurohet që vendimet e Bashkimit Evropian të jenë në interesin ekonomik të tij dhe se reagimet e pjesës tjetër të botës - veçanërisht të Shteteve të Bashkuara - nuk mund të injorohen. (dw)

Konjufca uron Irlandën për marrjen e Presidencës së BE-së: Presim bashkëpunim

PRISHTINË, 3 KORRIK - Ministri në detyrë i Punëve të Jashtme, Glauk Konjufca, ka uruar homologen e tij irlandeze, Helen McEntee, për marrjen e kryesimit të Presidencës së Këshillit Evropian të BE-së për gjashtëmuajorin e ardhshëm. "Urime Irlandës për marrjen

e Presidencës së Këshillit të Bashkimit Evropian. I shpreh urimet më të mira Ministres së Punëve të Jashtme, Helen McEntee, dhe ekipit të saj për një mandat të suksesshëm dhe produktiv", ka shkruar Konjufca në platformën "X". Ai ka shtuar se përkushtimi i

vazhdueshëm i Irlandës ndaj zgjerimit të Bashkimit Evropian ka një rëndësi të veçantë për rrugën evropiane të Kosovës, ndërsa shtoi se "pres me padurim bashkëpunimin e ngushtë me Presidencën irlandeze gjatë muajve në vijim".



PAGA MINIMALE 500 EURO: KUSH FITON, KUSH HUMB?

Paga minimale në Kosovë është rritur në 500 euro bruto në muaj, duke prekur, sipas zyrtarëve, rreth 150.000 punëtorë të sektorit privat. Derisa Qeveria e ka paraqitur vendimin si mbështetje për punëtorët, ekspertët vënë në pikëpyetje ndikimin e tij në mirëqenien e qytetarëve dhe ekonominë. Çfarë, realisht, pritet të sjellë kjo rritje?

PRISHTINË, 3 KORRIK - Mijëra punëtorë në Kosovë pritet të përfitojnë nga rritja e pagës minimale në 500 euro bruto në muaj, e cila hyri në fuqi më 1 korrik.

Por, mbetet e paqartë nëse kjo rritje do të përkthehet në një përmirësim të mirëfilltë të standardit të jetesës së tyre, përballë inflacionit dhe rritjes së vazhdueshme të çmimeve. Deri më tani, nuk është publikuar ndonjë analizë e hollësishme zyrtare mbi ndikimin e kësaj rritjeje apo në fuqinë blerëse të familjeve.

Ekspertë, me të cilët bisedoi Radio Evropa e Lirë, vlerësojnë se paga e re minimale nuk mjafton për të mbuluar shpenzimet mujore të një familjeje në Kosovë.

Qeveria e Albin Kurtit, tani kryeministër në detyrë, e mori këtë vendim në tetorin e 2025-tës, në prag të zgjedhjeve lokale, ndërsa ai hyri në fuqi në dy faza, në janar dhe në korrik 2026.

Vendimi prek rreth 150.000 punëtorë të sektorit privat, sipas zyrtarëve.

Mungesa e një studimi paraprak

Ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, kishte thënë pas vendimit për rritjen e pagës minimale se ai erdhi pas "analizave dhe diskutimeve që kemi pasur, si dhe propozimeve dhe sugjerimeve që kemi marrë nga përfaqësues të sindikatave dhe bizneseve". Por, pretendimet e Muratit hidhen poshtë nga kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Lulzim Rafuna, i cili akuzon Qeverinë për mospërfshirjen e Odës dhe të bizneseve në analizimin e ndikimit të pagës së minimale. "Nuk jemi konsultuar. Nuk e kemi parë asnjë raport, asnjë studim. Kjo është pikërisht kërkesa jonë",



thotë Rafuna për Radion Evropa e Lirë.

Ekonomisti Safet Gërxhalii vlerëson se Qeveria e "politizoi" pagën minimale, duke anashkaluar aktorët e tjerë nga diskutimet rreth ndikimit para marrjes së vendimit. "Asnjë pagë, qoftë minimale, qoftë mesatare, nuk duhet të politizohet, sepse kjo vetëm e dëmton aspektin ekonomik dhe social. Dhe, në këtë drejtim, definitivisht, paga minimale duhet të jetë e diskutuar dhe e kalkuluar në trendet e rritjes së inflacionit", shpjegon ai për Radion Evropa e Lirë.

A mjafton kjo rritje?

Paga minimale, tani 500 euro, u rrit fillimisht në 425 euro në janar, nga 350 sa ishte paraprakisht.

Me një inflacion të rritur në rreth 6.8 për qind, dhe një ekonomi të ngadalësuar, sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar, paga e re minimale në Kosovë nuk do të

ndihmojë në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve, thonë ekspertët. "Në rrethana reale, në një ekonomi të qëndrueshme, është dashur të fitojë qytetari, por duke pasur parasysh faktin që jemi një shtet i varur nga importi dhe afër 90% e të hyrave familjare shkojnë në konsum, atëherë shumë më tepër do të fitojnë tregtia dhe importi, sesa qytetarët dhe shteti", vlerëson Gërxhalii.

Një hulumtim, i publikuar më 2024 nga Instituti për Politika Sociale "Musine Kokalari", në Prishtinë, ka gjetur se një familje 4-anëtarëshe në Kosovë shpenzon mesatarisht mbi 1.100 euro në muaj për ushqim, strehim, arsim, shëndetësi dhe transport.

Në zonat urbane, shpenzimet arrijnë mbi 1.200 euro, ndërsa në ato rurale rreth 1.090 euro. Rafuna thotë se paga minimale prej 500 eurosh "nuk i mbulon" nevojat e kostot reale jetësore të familjes në Kosovë.

Ai shton se Qeveria ka mundur të vinte me një vendim më të

mirë për pagën minimale, sikur t'i jepte mundësi OEK-ut për të sjellë propozime pas bisedimeve me përfaqësuesit e tij, me anëtarët e Odës, por edhe me joanëtarët e saj.

Ndikimi tek bizneset dhe informaliteti

Ekspertët e ekonomisë parashikojnë ndikim negativ tek bizneset, që, sipas Gërxhalut, "nuk kanë qenë të përgatitura që do të ndodhë diçka e tillë", pasi nuk janë konsultuar nga Qeveria. "E tërë kjo do të ndikojë në radhë të parë në tkurrje apo në zvogëlim të vendeve të punës, në rendin e kërkesës për punëtorë dhe, kuptohet, si efekt i tretë do të jetë edhe tentativa për informalitet", vlerëson ai. Rafuna, në anën tjetër, pajtohet se bizneset mund të preken, por nuk mendon se do të ketë rritje të informalitetit. "Sipas të dhënave tona, nuk do të ketë informalitet, për shkak se [...] sektori privat ka lëvizur goxha mirë me paga si rezultat edhe i

kohës, por edhe si rezultat i kërkesës për të pasur fuqi punëtoresh të mirë dhe kualitative brenda ndërmarrjes", tregon ai. Ai shpjegon ndikimin tek bizneset e mesme dhe ato të reja, apo start-up. "Te bizneset e mesme, sfiduese është ngarkesa, se edhe është rritur pragu i pagës minimale, por edhe nuk është liru nga tatimi i të ardhurave personale", thotë ai.

Për shembull, fqinja e Kosovës, Shqipëria, në janar e rriti pagën minimale në 50.000 lekë, apo 500 euro, dhe vendosi se ajo nuk do të tatohet.

Ministria në detyrë e Financave në Kosovë nuk iu përgjigj pyetjes së Radios Evropa e Lirë nëse do të tatohet apo jo paga minimale.

Rafuna thotë se situata e re do të jetë "shumë sfiduese" edhe për bizneset e vogla, për shkak se "ato janë në hapat e parë, në ditët e para, dhe paga minimale prej 500 eurove padyshim që do t'i shtyjë ose ta kufizojnë numrin e stafit, ose të riorganizohen".

Shqipëria renditet e 43-ta në botë për fuqinë e pasaportës

TIRANË, 3 KORRIK - Shqipëria zë vendin e 43-të në botë nga 199 vende të marra në anketë sa i përket numrit të shteteve ku shtetasit shqiptarë mund të udhëtojnë pa vizë. Indeksi bazohet në të dhënat e Shoqatës Ndërkombëtare të Transportit Ajror (IATA) dhe kriteri kryesor është

numri i vendeve ku qytetarët e një shteti mund të udhëtojnë pa vizë paraprake. Në krye të listës qëndron Singapori, qytetarët e të cilit udhëtojnë pa vizë në 192 shtete. Vendin e dytë e ndajnë Japonia, Koreja e Jugut dhe Emiratet e Bashkuara Arabe me 188

vende, ndërsa Suedia është e treta me 187.

Vendin e katërt e ndajnë Belgjika, Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermania, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia dhe Spanja me 186 vende, dhe të pestin Austria, Greqia, Malta, Portugalia dhe Zvicra me

185.

Në rajon, Sllovenia renditet e 7-ta me 183 vende dhe Kroacia e 8-ta me 182. Serbia qëndron në vendin e 34-të. Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut e kanë përmirësuar pozicionin e tyre dhe ndajnë vendin e 41-të, me qasje pa viza në 127 shtete, pesë



destinacione më shumë se pasaporta shqiptare.



RAMA: DORËHEQJA NUK ËSHTË OPSION, MISIONI YNË ËSHTË ANËTARËSIMI NË BE

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka folur për zhvillimet e fundit në vend, veçanërisht për protestat, duke theksuar se në Shqipëri nuk është thyer besimi. “Në Shqipëri ekziston një shembull i bukur i lirisë dhe i demokracisë në veprim, një bulevard që u përket njerëzve nga të gjitha sferat e jetës, të cilët kanë pikëpamjet e tyre dhe duan që zëri i tyre të dëgjohet”, ka deklaruar Rama në një intervistë për Deutsche Welle (DW). Ai theksoi se dorëheqja e tij nuk ka qenë, nuk është dhe nuk do të jetë një opsion. Rama u shpreh se ai dhe Partia Socialiste janë mandatuar nga 868 mijë qytetarë shqiptarë për të përmbushur misionin e mbylljes së negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. “Ky është një mision historik që nuk mund të lihet në gjysmë për asnjë arsye”, ka thënë Rama

PRISHTINË, 3 KORRIK-

Kryeministër Edi Rama, jemi këtu në “Jahrhunderthalle” dhe sapo ju dëgjova të mbani një fjalim kryesor, ku folët për Inteligjencën Artificiale dhe demokracinë, pushtetin dhe qeverisjen. Shqipëria është në pritje të një prurjeje të madhe parash. Po flasim për 4 miliardë euro që vijnë nga zhvillimet turistike në vijën bregdetare. Mendoj se pyetja ime hapëse është se çfarë roli do të luajë Inteligjenca Artificiale në mbikëqyrjen e këtyre parave?

Edi Rama: Nuk shoh lidhje mes të dyjave, por ajo që mund të them është se përmes Inteligjencës Artificiale, ne mund t'i japim vetes çdo ditë më shumë njohuri dhe mund të përfitojmë nga një ndihmë që është absolutisht e paimagjinueshme në aftësinë për të na informuar, në aftësinë për të na këshilluar. Pra, aty do

të shkojë gjithçka.

Po në lidhje me çështjen e besimit? Ju folët për arkitekturën e pushtetit. Për momentin, në Shqipëri, ka një thyerje besimi tek ajo “arkitekturë”. Demonstruesit po flasin për mungesën e konsultimit dhe mbikëqyrjes demokratike, mungesën e konsultimit me publikun dhe mbikëqyrjen. Si do t'i siguroni ata se kjo do të ndodhë?

Edi Rama: Në Shqipëri nuk është thyer besimi. Në Shqipëri, ekziston një shembull i bukur i lirisë, i demokracisë në veprim, i një bulevardi që u përket njerëzve nga të gjitha sferat e jetës që kanë pikëpamjen e tyre, që duan që zëri i tyre të dëgjohet. Pra, kjo është një meritë për Shqipërinë dhe ky nuk është problem për Shqipërinë. Ky është një shembull i shkëlqyer se sa larg

kemi arritur, duke kujtuar se në të njëjtin bulevard, jo një shekull më parë, por vetëm gjatë jetës sonë politike, u vranë njerëz duke protestuar. Pra, do të thosha se ky është një shembull i bukur që Shqipëria po i tregon botës dhe është një shembull shumë unik për rajonin tonë.

Do të doja shumë të flisja me ju për bukurinë, sepse si artist, ju e kuptoni rëndësinë e bukurisë dhe e kuptoni se si transformimi publik i hapësirës mund të ndryshojë mënyrën se si një komb ndihet për veten. Nëse e ardhmja e Shqipërisë duket si një resort luksoz Trump-Kushner, çfarë tregon kjo për Shqipërinë që po krijoni?

Edi Rama: Para së gjithash, mund të më japin leksione për shumë gjëra - për ekonominë, për çështjet ligjore, për bujqësinë, për kujdesin

shëndetësor - por ka një gjë për të cilën askush nuk mund të më bëjë leksione dhe kjo është bukuria. Dhe jo sepse jam artist, por sepse kam shërbyer si ministër i Kulturës, kam shërbyer si kryetar bashkie dhe po shërbej si kryeministër, duke e bazuar pikërisht të gjithë mendimin tim te bukuria. Dhe transformimi i hapësirës publike dhe transformimi i hapësirave urbane ka qenë pjesë e rrugëtimit tim. Dhe nëse Shqipëria sot po mirëpret 12 milionë turistë, është falë kësaj përpjekjeje. Pra, bukuria është diçka në të cilën besoj, është diçka për të cilën luftoj. Tani, ju sillni emra këtu sepse jeni paragjyquese. Nuk jam në gjendje të përgjigjem...

A është kjo..?

Edi Rama: Jo, jo, më lejoni të përfundoj. Nuk jam në gjendje të përgjigjem sepse ju

përmendni emra. “Si mund të duket një projekt nga Trump dhe Kushner?” Çfarë është kjo pyetje? Si mund t'i përgjigjesh? Unë nuk po përmend asnjë projekt. Projekti është duke u zhvilluar dhe kur të jetë gati, atëherë do ta diskutojmë projektin. Nuk do të diskutojmë për njerëz, personazhe dhe beteja ideologjike me njerëz. Këto janë betejat tuaja. Mund t'i bëni ju, por nuk është beteja ime. Beteja ime është të sjell në Shqipëri investime të huaja direkte. Beteja ime është të nxis zhvillime që do të jenë absolutisht - jo thjesht të shkëlqyera për Shqipërinë, por do të jenë një dhuratë për Europën.

A është privatizimi i hapësirës publike një çmim që jeni të përgatitur ta paguani për këtë transformim?

Edi Rama: Kjo është një tjetër

IKD, KDI DHE FOL: PROCESI PËR PËRZGJEDHJEN E KRYEPROKURORIT TË RI TË SHTETIT DERI MË TANI ISHTE I RREGULLT

PRISHTINË, 3 KORRIK - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe Lëvizja FOL kanë monitoruar procesin e deritanishëm për përzgjedhjen dhe emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit. Monitorimi ka përfshirë fazat kryesore të procesit, përfshirë miratimin e rregullativës përkatëse normative në funksion të zgjedhjes së

Kryeprokurorit, konfirmimin e kandidaturave, hartimin e pyetjeve si dhe intervistimin e pesë kandidatëve. Bazuar në monitorimin e fazave të zhvilluara deri më tani, koalicioni i këtyre OJQ-ve vlerëson se Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka arritur të zhvillojë një proces të rregullt, transparent dhe të barabartë ndërmjet kandidatëve. “Ky vlerësim i referohet procesit deri


në fazën e intervistimit, ndërsa vlerësimi përfundimtar do të varet edhe nga ligjshmëria, arsyetimi dhe transparenca e hapave të mbetur proceduralë”, thuhet në njoftimin për media. IKD, KDI dhe FOL ka theksuar se do të vazhdojnë monitorimin deri në përfundimin e të gjitha fazave procedurale. Pas përfundimit të procesit, Koalicioni i OJQ-ve do të publikojë raportin përfundimtar.



gënjeshtër që po thuhet shpesh dhe është bërë fakt, të cilin ju tani po e përdorni për të ngritur një pyetje, sepse nuk ka privatizim të hapësirës publike. E thjeshtë! Nuk ka! Është gënjeshtër.

Ju mund të garantoni që të gjithë do të kenë qasje...

Edi Rama: Nuk është se mund ta garantoj. Jetojmë në një qytetërim, i cili që nga koha e romakëve ka marrë një vendim shumë të thjeshtë: Kushdo që bën akuza duhet të japë prova. Ju jeni gazetarë, apo jo? Dhe jeni këtu për të informuar audiencën tuaj. Dhe pyetja juaj bazohet në një gënjeshtër. Dhe më pyesni për “garanci”, ndërsa duhet të më tregoni se ku është privatizimi dhe ku është ndonjë e dhënë që keni gjetur që ju shqetëson se do të ketë privatizim të tokës publike. Nuk do të ketë! Nuk ka ndodhur kurrë dhe nuk do të ndodhë.



Në vitin 2024, ligjet e Shqipërisë për mbrojtjen e mjedisit u ndryshuan me qëllim hapjen e rrugës për turizmin e hoteleve luksoze. Dhe kjo është diçka që i ka shqetësuar njerëzit në Shqipëri, së bashku me shqetësimet e tyre për mungesën e konsultimit publik. Cila është përgjigja juaj ndaj këtyre shqetësimeve?

Edi Rama: Unë mendoj se, përsëri, faktet janë shumë të rëndësishme. Por përsëri, faktet lihen mënjani. Sepse po, ne kemi bërë ndryshime në ligj. Por a e dini çfarë? Ne nuk e ndryshuam thelbin e ligjit dhe ndryshimet tona nuk janë në shkëlqje të standardeve dhe kriterëve evropiane, të cilat do të sigurohemi që të verifikohen përmes një procesi që ka të bëjë me negociatat tona. Pra, përsëri, paragjykimet nuk janë argumente dhe insinuatat nuk janë fakte. Dhe faktet janë e vetmja gjë që kam. Nëse keni fakte për të sfiduar faktet e mia, ju lutem m'i sillni. Por nëse keni paragjykimet dhe nëse keni beteja ideologjike për të bërë

me Trump dhe nëse keni gjëra të tjera në mendje, jeni të lirë t'i keni ato, por unë nuk mund t'ju ndihmoj me përgjigjet e mia.

Në fjalimin tuaj ju folët për zemëratën digjitale. Ju shpikët fjalën “angerithm”. Dhe gjithashtu folët për përvojën shumë pozitive të qeverisë suaj me përdorimin e AI-së, duke përfshirë edhe futjen në punë të një ministreje që është edhe vetë një algoritëm i Inteligjencës Artificiale. Nëse jemi në një situatë ku kemi përdorim të mirë algoritmik dhe atë që ju e keni quajtur përdorim të keq algoritmik - ose edhe përdorim të rrezikshëm algoritmik - ku na çon kjo? A na çon kjo në një situatë kontrolli qeveritar të algoritmeve?

Edi Rama: Nuk ka një gjë të tillë, pra përdorim të mirë algoritmik, sepse algoritmit nuk i pëlqen e vërteta e mërziçkime. Algoritmit i pëlqejnë gënjeshtret argëtuese. Algoritmi nuk i pëlqen nuancat. Algoritmit i pëlqen skandalë.

Algoritmit nuk i pëlqen paqja dhe dashuria. Algoritmit i pëlqen zemërimi dhe frika. Sepse është natyra njerëzore që tërhiqet më shumë nga të gjitha këto. Dhe nuk është puna ime të them se si mund të zgjidhet kjo, në një shoqëri demokratike, si Evropa. Por mendoj se Evropa dhe bota demokratike po bëjnë një gabim, që një ditë mund të jetë arsyeja e fundit të demokracisë, e cila është pranimiti i lirisë së “reach”, si një zgjatim i lirisë së fjalës. Liria e “reach” (shtrirjes) nuk është liri e fjalës. Liria e shtrirjes është ajo që diktaturat kishin si armën e tyre më vdekjeprurëse kundër lirisë. Të hyjnë në tru dhe të mbjellin atje të vërtetën e tyre, duke shtypur çdo të vërtetë tjetër. Algoritmi nuk ka nevojë të shtypë me polici sekrete ose me gjyqtarë të kontrolluar. Algoritmi shtyp përmes mbytyes dhe përmes amplifikimit. Duke amplifikuar gënjeshtret, duke mbytur të vërtetën. Çdo studim thotë se ajo që shpërblehet në mediat sociale janë gënjeshtret.

Ajo që pranohet më pak, është e vërteta.

Z. Rama, protestat në Shqipëri kanë hyrë në muajin e tyre të dytë. Në ditët e para keni thënë që për herë të parë në gjithë këto vite qeverisjeje, ju keni konsideruar, e keni menduar dorëheqjen. Para pak ditësh thatë që ky nuk është një opsion, pasi jeni votëbesuar nga populli shqiptar për ta anëtarësuar Shqipërinë në Bashkimin Evropian. Janë dy versione të kundërta. Pas një muaji protestash, cili është qëndrimi juaj?

Edi Rama: Nuk janë dy versione të kundërta. Unë kam ndarë në grupin parlamentar opinionet e mia dhe kam shprehur një ndjesi lidhur me faktin se unë jam zgjedhur dhe qëndroj në detyrë për t'i bërë gjërat, jo për t'u tërhequr zvarrë. Dhe ndërkohë, dorëheqja nuk ka qenë, nuk është dhe nuk do të jetë opsion për një arsye shumë të thjeshtë: sepse unë jam mandatuar së bashku me Partinë Socialiste nga 868 mijë

shqiptarë për të realizuar misionin e mbylljes së negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Dhe ky është një mision historik që nuk mund të lihet në mes për asnjë arsye. Dhe për më tepër pastaj, për faktin se një pjesë e qytetarëve zgjedhin të protestojnë. Nga ana tjetër, protesta është diçka jashtëzakonisht kuptimplotë për Shqipërinë, për nivelin e lirisë, për nivelin e demokracisë dhe për faktin që në Shqipëri protestohet. Njerëz nga të gjitha rrugët e jetës dalin, kanë gjërat e tyre për të cilat dalin, ne kemi detyrën t'i dëgjojmë, kemi detyrën ta lexojmë çdo mesazh që ata na japin, dhe këtë po bëjmë.

Nëse Edi Rama nuk do të ishte në petkun e Kryeministrit, do të kishte dalë të protestonte për spitale më të mira, për ikjen e trurit që vazhdon prej vitësh, për një sistem, për një administratë më të mirë të cilën e akuzuat para pak ditësh, e fajësuar të themi si përgjegjëse?

Edi Rama: Unë nuk kam arsye për të menduar që do të dilja aty, nëse do të bazohesha në faktet dhe në informacionin e vërtetë. Nëse do bazohesha në të gjitha llojet e manipulimeve, gënjeshtre dhe amplifikimeve, patjetër do dilja edhe unë aty. Por faktet dhe informacioni i vërtetë është ndryshe. Pastaj shëndetësia, arsimit edhe të gjithë të tjerat kanë problemet që kanë. Problemet nuk lindën ditën që filloi protesta, problemet kanë qenë aty, janë shtruar në rrugën e zgjedhjes, janë zgjidhur pjesërisht. Dhe për të çuar përpara zgjedhjen e tyre kemi marrë mandatin e popullit shqiptar me shumicën më të madhe ndonjëherë që kur unë udhëheq Partinë Socialiste. Kështu që nuk mundet dot që të çohesh një ditë të bukur dhe të thuash që “unë dua shëndetësi më të mirë dhe kjo qeveri duhet të ikë”. Nuk funksionon. Duhet të presësh kur të vijnë zgjedhjet e tjera.

EKREM BAJROVIQ DËNOHET ME 12 VJET BURGIM NË RIGJYKIM PËR KRIME LUFTE NË KOSOVË

PRISHTINË, 3 KORRIK - Gjykata në Prishtinë e ka dënuar të premtën me 12 vjet burgim Ekrem Bajroviqin, në rigjykimin e tij për krime lufte kundër popullsisë civile në Kosovë gjatë luftës së viteve 1998 - '99.

Bajroviq u shpall fajtor përsëri për kryerjen e krimeve të luftës kundër civilëve shqiptarë në fshatrat Staradran, Zallc, Gurrakoc dhe fshatrat tjera përreth të Komunës së Istogut në fillim të vitit 1999.

Ai u dënua në rigjykim pasi rasti kundër tij ishte kthyer në rivendosje nga Gjykata Supreme vitin e kaluar.

Gjykata Themelore e kishte dënua me 12 vjet burgim atë edhe në korrik të vitit 2024 dhe Gjykata e Apelit e kishte vërtetuar atë aktgjykim duke e hedhur poshtë ankesën e palës mbrojtëse më 2025.

Megjithatë, Gjykata Supreme e pranoi ankesën e mbrojtjes më 2025 dhe e rrëzoi aktgjykimin ndaj Bajroviqit, duke thënë se disa dëshmitarë kishin deklaruar gjatë shqyrtimit gjyqësor se për këtë rast kishin dhënë deklarata edhe para autoriteteve të UNMIK-ut dhe EULEX-it, por ato nuk ndodheshin në shkresat e lëndës.

Gjykata kishte vlerësuar se këto deklarata duhej të siguroheshin dhe të shqyrtoheshin së bashku me provat e tjera.

Bajroviq ka të drejtë ankese edhe ndaj dënimit të tanishëm në shkallë të parë.

Për çfarë krimesh u dënua Bajroviq?

Sipas aktgjyimit, më 7 dhe 8 maj të vitit 1999, Bajroviq mori pjesë në një aksion të forcave serbe kundër popullatës civile shqiptare në fshatrat e Istogut, civilët u detyruan të largoheshin nga shtëpitë e tyre dhe u urdhëruan të niseshin drejt Shqipërisë.

Bajroviq i ndau burrat dhe gratë nga kolona e nisur drejt Shqipërisë, duke i plaçkitur dhe më pas forcat serbe i dërguan ata në një shtëpi në Staradran, duke i "pushkatuar të paktën 16 civilë të kombësisë shqiptare", sipas gjykatës.

Po ashtu, sipas gjykatës, më 7 maj të 1999, Bajroviq kishte marrë pjesë në "arrestimin dhe keqtrajtimin e 84 civilëve të kombësisë shqiptare, ashtu që fillimisht të dëmtuarit [burrat] i ndajnë nga kolona tjetër e civilëve, u marrin të gjitha paratë dhe sendet e tjera me vlerë e pastaj që të gjithë i dërgojnë në Gurrakoc në lokalit të Sh.S, ku i kishin maltretuar dhe torturuar në mënyrë çnjerëzore".

Ndërsa, më 8 maj 1999, të ndaluarit i kishin dërguar në



Dëshmitarët e masakrës së Saradanit: Dënimi me 12 vjet burgim për Ekrem Bajroviqin është qesharak

Dëshmitarët e masakrës së Saradanit kanë shprehur pakënaqësi lidhur me vendimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës, e cila edhe në rigjykim e ka dënua me 12 vjet burgim Ekrem Bajroviqin, i akuzuar për krime lufte gjatë viteve 1998 - 1999.

Dëshmitari Naim Elshani e quajti këtë vendim qesharak, duke treguar se ende i bart në trup

plagët nga tortura që i është bërë. "Unë nuk pajtohem me këtë vendim. Ky vendim është qesharak. 12 vjet burgim t'i merr një kriminel ku me sytë e mi e pashë në krim, tortura që i përjetova. Ende sot plagët më kullojnë gjak. Domethënë, është tmerr. Unë nuk pajtohem me këtë vendim", ka thënë Elshani. Edhe dëshmitari tjetër, Ylber Lipa,

shfaqti pakënaqësi lidhur me këtë vendim. "Pavarësisht zgjatjes së procesit, së paku ne katër dëshmitarë prej 32-ve që jemi sot, jemi të pakënaqur me vendimin, edhe pse e kemi parasysh se ligjet e asaj kohe me të cilat është dënua, dënimi maksimal është 15 vite. E keqja e gjithë kësaj është mospërkrahja e dëshmitarëve nga shteti", ka thënë ai.



stacionin policor në Gurrakoc, ku kolonës i printe" i akuzuari Bajroviq.

Bajroviqit, në kuadër të dënimit do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim, pra nga 19 tetori i vitit 2022.

Gjatë luftës në Kosovë janë vrarë më shumë se 13.000 civilë - shumica shqiptarë, ndërsa mijëra të tjerë janë zhdukur.

Më shumë se 1.500 persona

vazhdojnë të jenë ende të pagjetur, pjesa më e madhe e tyre shqiptarë.

Kohët e fundit, autoritetet kosovare kanë arrestuar të dyshuar të shumtë dhe kanë ngritur një sërë aktakuzash për krime lufte në Kosovë.

Ndërkaq, që nga përfundimi i luftës, dhjetëra të dyshuar janë dënua për këto krime para institucioneve vendore dhe

ndërkombëtare.

Fillimisht pas luftës, përkatësisht nga viti 2000 dhe 2008, krimet e luftës në Kosovë u hetuan nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), ndërsa nga viti 2008, nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX).

Më 2018, EULEX-i ia dorëzoi lëndët organeve vendore të drejtësisë.

KOMANDANTI I FSK-së TAKON GJENERALËT AMERIKANË NË CEREMONINË E USAREUR-AF

PRISHTINË, 3 KORRIK - Me ftesë të Komandantit Suprem të Forcave Aleate në Evropë (SACEUR) dhe Komandant i Komandës Evropiane të Shteteve të Bashkuara (EUCOM), gjeneral Alexis G. Grynkeuich, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës gjeneral Bashkim Jashari, ka marrë pjesë në ceremoninë e ndërrimit të Komandantit të Ushtrisë Amerikane për Evropë dhe Afrikë (USAREUR-AF) gjeneral Christopher T. Donahue.

Gjatë takimit, GLT Jashari shpreh vlerësimin e tij të lartë për lidhshmërinë e gjeneralit Donahue në drejtimin e kësaj komande me rëndësi strategjike për Evropën, duke e falënderuar njëherësh për mbështetjen e vazhdueshme që ka ofruar në

zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, si dhe për kontributin e tij në avancimin e bashkëpunimit ndërmjet forcave tona.

Në anën tjetër, gjeneral Donahue e falënderoi gjeneral Jasharin për pjesëmarrjen në ceremoni dhe për bashkëpunimin e ngushtë dhe të suksesshëm gjatë kësaj periudhe, me theks të veçantë në zgjerimin e aktiviteteve të përbashkëta, përfshirë trajnimet dhe ushtrimet e realizuara, të cilat kanë kontribuar në forcimin e ndërveprueshmërisë dhe partneritetit ndërmjet dy forcave.

Gjatë ceremonisë KOMFSK takoi edhe homologë të vendeve partnere të NATO-s, pjesëmarrës në këtë ceremoni.



Gjithashtu, takoi edhe zëvendëskomandantin dhe ushtruesin e detyrës së Komandantit të USAREUR-AF Gjeneralmajor Christopher Norrie, me të cilin u dakorduan për vazhdimin e bashkëpunimit dhe aktiviteteve të përbashkëta.

Në përmblyllje të ceremonisë, palët rikonfirmuan përkushtimin e përbashkët për avancimin e bashkëpunimit ndërmjet FSK-së dhe Komandës së USAREUR-AF), duke vlerësuar se partneriteti i qëndrueshëm strategjik, avancimi i bashkëpunimit dhe zhvillimi i mëtejme i kapaciteteve mbrojtëse të forcës janë thelbësore për forcimin e sigurisë, ruajtjen e stabilitetit dhe promovimin e paqes së qëndrueshme në Kosovë dhe më gjerë.

FSK-së I SHTOHEN EDHE 12 KADETË TË RINJ

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 KORRIK - Në Kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë u mbajt ceremonia solemne e diplomimit dhe betimit të 12 kadetëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, të cilët përfunduan me sukses studimet katërvjeçare në programin ushtarak në Qendrën për Studime Universitare pranë Akademisë së Mbrojtjes së FSK-së, si dhe përgatitjen akademike në Universitetin Amerikan në Kosovë.

Në ceremoni morën pjesë ushtruesja e detyrës së presidentes së Republikës së Kosovës, Albulena Haxhiu, kryeministri në detyrë, Albin

Kurti, ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, KOMFSK, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, udhëheqës të lartë të FSK-së, oficerë, nënoficerë, përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës, partnerë ndërkombëtarë, si dhe familjarë e mysafirë të shumtë. Ceremonia filloi me raportimin para ushtrueses së detyrës së presidentes së Republikës së Kosovës, dhe Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, ndërsa kulmoi me betimin solemn të kadetëve të gjeneratës 2026.

Pas dhënies së betimit, ata u graduan me gradën nëntoger, duke u bërë udhëheqës të rinj të Forcës së Sigurisë së Kosovës, të gatshëm për t'i



shërbyer Republikës së Kosovës me profesionalizëm, integritet dhe përkushtim.

Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka thënë se sot është një

ditë krenarie për shtetin, sepse në kazermën që mban emrin e kryekomandantit të UÇK-së, Adem Jashari, diplomuan disa nga udhëheqës të ardhshëm të

ushtrisë sonë. "Krahas investimeve mbi 460 milionë euro për blerje armatimi, kemi dyfishuar numrin e ushtarëve, kemi katërfishuar trajtimet e mbi të gjitha kemi mbështetur shkollimin dhe edukimin e tyre. Për katër vjet, do të investojmë 1 miliard euro të tjera, do t'i kemi një mijë vajza e gra në ushtrinë tonë dhe do të kemi fabrikën e municioneve 'Made in Kosova'", ka theksuar Kurti.

Diplomimi dhe betimi përfaqëson një moment të rëndësishëm në zhvillimin e kapaciteteve profesionale të FSK-së dhe një dëshmi të përkushtimit për ndërtimin e një force moderne, të aftë dhe në përputhje me standardet më të larta ushtarake.

MBI 1.5 MILIONË EURO GRANTE PËR BIZNESE, LANSOHEN SKEMAT PËR INOVACION DHE ENERGJI TË PASTËR

PRISHTINË, 3 KORRIK - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI), në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, ka lansuar dy skema grantesh për mbështetjen e bizneseve: skemën për inovacion dhe skemën për energji të pastër, me një buxhet të përgjithshëm prej mbi 1.5 milionë eurosh. Skema për inovacion, me një buxhet prej 1.16 milionë eurosh, synon të mbështesë zhvillimin e produkteve, shërbimeve dhe proceseve inovative në sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK). Ndërkaq, skema për energji të



pastër, me një buxhet prej 380 mijë eurosh, do të financojë investimet në sisteme solare, masa për eficientë energjetike dhe pajisje që ulin konsumin e energjisë në ndërmarrje. Ministria në detyrë e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, prezantoi skemën për inovacion, e cila, sipas saj, ka për qëllim mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, si dhe të bizneseve start-up. Ajo theksoi se në këtë skemë MINTI ka kontribuar me 600 mijë euro, ndërsa LuxDev me 560 mijë euro. Ndërkaq, ministria në

detyrë e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, prezantoi skemën për energji të pastër, e cila do të mbështesë investimet e reja. "Sot po e lansojmë fazën e dytë me një skemë të ngjashme, me një buxhet prej 380 mijë eurosh për të mbështetur investimet e reja. Përmes kësaj skeme, ndërmarrjet do të kenë mundësi të përfitojnë grante deri në 25 mijë euro", tha Rizvanolli.

I ngarkuari me Punë i Dukatit të Madh të Luksemburgut në Kosovë, Eric Dietz, tha se LuxDev do të vazhdojë t'i mbështesë bizneset që të rriten dhe të bëhen më të qëndrueshme.

GASHI: ÇDO QYTETAR DO TA KETË MJEKUN E VET FAMILJAR NË PRISHTINË

PRISHTINË, 3 KORRIK - Drejtori i drejtorisë së Shëndetësisë në Komunën e Prishtinës, Bujar Gashi, ka bërë të ditur se sistemi shëndetësor në Kosovë synon të kalojë në modelin ku çdo qytetar do të ketë mjekun e vet familjar, ndërsa vlerësoi se pritjet deri në 30 minuta në qendrat e mjekësisë familjare janë të pranueshme, duke marrë parasysh ngarkesën e sistemit.

Në podcastin "Shëndeti në rend të parë" në "Telegraf", e

mbështetur nga United Hospital, Gashi tha se përzgjedhja e mjekut familjar është pjesë e reformave që po zhvillohen në nivel kombëtar dhe se qytetarët do të kenë mundësi të zgjedhin vetë mjekun që dëshirojnë t'i ndjekë në vazhdimësi. "Ne jemi pjesë e grupeve punuese dhe po përgatitemi për këtë proces. Do të jetë një garë e përzgjedhjes së mjekëve, sepse jo të gjithëve na përshtatet i njëjti mjek. Ata që regjistrohen të parët do të kenë

mundësi të zgjedhin mjekun që preferojnë", tha Gashi.

Sipas tij, në praktikë shumë qytetarë tashmë kanë krijuar besim te një mjek i caktuar dhe vazhdojnë ta kërkojnë atë sa herë që kanë nevojë për shërbime shëndetësore.

"Edhe sot, kur qytetarët vijnë në qendrat tona, shpesh kërkojnë një mjek të caktuar dhe thonë: 'Ky është mjeku im'. Me sistemin e ri kjo praktikë do të formalizohet edhe elektronikisht, përmes

regjistrimit dhe caktimit të termineve", u shpreh ai.

Duke komentuar ankesat e qytetarëve për pritjet në qendrat e mjekësisë familjare, Gashi tha se ato duhet të vlerësohen në raport me numrin e madh të vizitave dhe kapacitetet aktuale të sistemit. "Me numrin që kemi të mjekëve dhe infermierëve, me rreth 1.25 milion vizita dhe mbi 3.5 milion shërbime në kujdesin parësor gjatë një viti, nuk e quaj pritje nëse pacienti pret më pak

se 30 minuta", deklaroi ai.

Ai theksoi se sistemi shëndetësor në Kosovë, pavarësisht sfidave, ofron një qasje shumë më të shpejtë te mjeku familjar sesa në shumë vende evropiane. "Në shumë shtete fillimisht telefononi, merrni këshilla dhe mund të prisni disa ditë për një vizitë. Ndërsa te ne, qytetari zakonisht nisat nga shtëpia, shkon në institucion dhe brenda 15 deri në 30 minutave e kryen vizitën", tha Gashi.

Gërvalla thotë se pakoja e reformës në drejtësi drejt finalizimit institucional

PRISHTINË, 3 KORRIK - Nën udhëheqjen e zëvendëskryeministres dhe ministres së Drejtësisë në detyrë, Donika Gërvalla, u mbajt takimi për shqyrtimin dhe finalizimin e pesë projektligjeve që janë pjesë e Deklaratës së Përbashkët të Zotimit për reformë në drejtësi. Në këtë takim mori pjesë edhe zëvendësministri i Drejtësisë, Genc Nimoni si dhe përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të

Kosovës dhe Akademisë së Drejtësisë.

Në fjalën e saj, ministria Gërvalla tha se përmes një diskutimi të hapur dhe profesional, diskutuan dhe harmonizuan dispozitat e këtyre projektligjeve, me synimin që ato të finalizohen në përputhje me standardet kushtetuese dhe praktikant më të mira ndërkombëtare. "Reforma në drejtësi nuk është thjesht një proces ndryshimesh ligjore. Është një domosdoshmëri

shtetërore për ndërtimin e një sistemi drejtësie që nuk toleron kompromis me integritetin, që e vendos llogaridhënien në themel dhe që rikthen besimin e qytetarëve në institucionet e drejtësisë", deklaroi ministria Gërvalla.

Ministria e Drejtësisë shpreh përkushtimin që përmes dialogut ndërinstitucional dhe bashkëpunimit të ngushtë me të gjithë akterët e sistemit, të zbatoj reforma që e forcojnë sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës



Kapen 23,500 euro të padeklaruar në Pikën Kufitare Merdarë

PRISHTINË, 3 KORRIK - Dogana e Kosovës, në bashkëpunim me Policinë Kufitare të Kosovës, ka zbuluar mjete monetare të padeklaruar gjatë kontrollit të një automjeti në dalje të Pikës së Kalimit Kufitar Merdarë.

Automjeti ishte përzgjedhur për kontroll në bazë të analizës së riskut. Gjatë intervistimit fillestar, zyrtari doganor e kishte pyetur udhëtarin nëse posedonte mallra ose mjete monetare që i nënshtroheshin deklarimit.

Pas përgjigjes së dhënë, automjeti u referua për kontroll të detajuar në vijën e dytë.

Gjatë kontrollit të përbashkët nga zyrtarët doganorë dhe Policia Kufitare, u zbuluan mjete monetare të padeklaruar në dy lokacione të ndryshme të automjetit.

Një shumë prej 10,000 euro u gjet në çantën personale të udhëtarit, ndërsa 13,500 euro u zbuluan të fshehura në zarfe brenda një ndarjeje të automjetit. Në total, u evidentuan 23,500 euro mjete monetare.

Personi posedonte gjithashtu një kontratë noteriale për shitblerjen e një prone, të datës 29.06.2025, si dhe një dëshmi të

tërheqjes bankare, të datës 01.07.2026, të cilat shërbenin si dokumentacion mbi prejdardhjen e mjeteve monetare.

Pas konstatimit të mosdeklarimit, rasti u referua menjëherë oficerit kujdestar të Hetimeve Doganore për trajtim të mëtejshëm. "Në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon deklarimin e mjeteve monetare gjatë hyrjes dhe daljes nga territori i Republikës së Kosovës, ndaj palës u aplikuan masat e parapara ligjore. Duke qenë se personi kishte dokumentuar burimin e

ligjshëm të mjeteve monetare, u vendos ndalimi i 25% të shumës së padeklaruar, ndërsa pjesa tjetër iu kthye poseduesit, në pajtim me procedurat dhe dispozitat ligjore në fuqi", ka njoftuar Dogana.

Dogana e Kosovës rikujton se çdo person fizik që hyn ose del nga territori i Republikës së Kosovës me mjete monetare në vlerë prej 10,000 euro ose më shumë (ose kundërvlerën e tyre në valuta të tjera apo instrumente të negociueshme) ka detyrim ligjor t'i deklarojë ato pranë autoriteteve doganore. "Mosdeklarimi ose



deklarimi i pasaktë përbën kundërvajtje dhe sjell pasojat ligjore, përfshirë ndalimin e përkohshëm ose konfiskimin e një pjese të mjeteve monetare, sipas legjislacionit në fuqi", ka njoftuar Dogana.

ÇFARË NDODHI ME FABRIKËN E QUMËSHTIT NË ISTOG?

PRISHTINË, 3 KORRIK - Fabrika e qumështores "Vita" në Istog është mbyllur përkohësisht nga vetë kompania, pasi inspektorët të Agjencisë të Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) kryen kontrole gjatë 2 korrikut.

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë tha pas inspektimeve në fabrikën e qumështit në Istog se në këtë fazë nuk është marrë asnjë masë për mbylljen e fabrikës. "Inspektimi ka konsistuar vetëm në verifikim dhe marrje mostrash, ndërsa vlerësimi i plotë dhe konstatimet përfundimtare do të bëhen pas pranimit të rezultateve laboratorike, në përputhje me legjislacionin në fuqi", tha AUV.

Kjo agjenci tha se inspektimi u krye për të verifikuar përputhshmërinë e aktivitetit të kompanisë me standardet e sigurisë ushqimore. Ajo tha se ka marrë mostra të qumështit që ka afat të gjatë përdorimi, të qumështit pluhur dhe të vajit të palmës, që janë dërguar për analiza laboratorike.

Agjencia e Ushqimit tha se gjatë kontrollit fizik të objektit gjeti mospërputhje me ligjet në fuqi. "Është evidentuar se operatori ushtron veprimtari të përpunimit të qumështit në bazë të autorizimit përkatës, ndërsa në objekt janë instaluar edhe linja për prodhimin e produkteve me



origjinë shtazore dhe me bazë qumështi, duke përdorur qumësht pluhur, vaj palme dhe lëndë të tjera ndihmëse. Po ashtu, subjekti disponon sasi të konsiderueshme të lëndëve të para dhe produkteve, përfshirë qumësht UHT, qumësht pluhur, proteina qumështi, hurrë qumështi dhe vaj palme", u tha në njoftim.

Gjithashtu, agjencia tha se fabrika nuk posedon autorizim të veçantë për prodhimin dhe përpunimin e produkteve me bazë yndyrash bimore dhe proteinash qumështi "për qëllime të deklaruara në etiketim, ndërsa disa elemente të procesit kërkojnë vlerësim të mëtejshëm nga autoritetet kompetente".

Përplasjet mes kompanisë dhe ekzekutivit

Inspektimet çuan në përplasje mes drejtuesve të kompanisë dhe ministrit në detyrë të Bujqësisë, Armend Muja.

Drejtori i përgjithshëm i fabrikës "Vita", Artan Spahia, tha para mediave se inspektimet u kryen nga inspektorët e AUV-së me vendim të vetë ministrit Muja. Ai tha se vendimi që i është dhënë nga një këshilltareje të Mujës - që sipas tij as nuk u prezantua - është marrë vetëm për kompaninë e tij dhe vendimi është nënshkruar sot.

Ai e akuzoi ekzekutivin se po i trajton sikur të ishin "kriminelë".

Muja u kundërpërgjigj përmes një postimi në Facebook, duke thënë se siguria ushqimore kërkon zbatim të barabartë të ligjit. Sipas tij, qytetarët duhet të dinë se çfarë ushqimi konsumojnë. "Kontrollet që po zhvillon Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë në sektorin e qumështit dhe produkteve të qumështit janë pjesë e mandatit të saj të rregullt ligjor për të mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për ushqimin dhe standardeve të sigurisë ushqimore. Njëjtë edhe kjo sot në kompaninë "Vita", tha Muja, sipas të cilit, qëllimi i vetëm i kontrolleve është mbrojtja e interesit publik.

Po në këtë postim, Qumështorja "Vita" iu kundërpërgjigj Mujës, duke thënë se kompania nuk është kundër kontrolleve dhe duke pretenduar se ajo ka investuar miliona euro për standarde të sigurisë ushqimore, teknologji moderne dhe bënë kontroll të vazhdueshëm të cilësisë. "Inspektimi i sotëm që e patëm nga AUV dhe IQT [Inspektorati Qendror i Tregut], së bashku me Grupin Punues, është iniciuar direkt nga ana juaj, personalisht, me vendim të nënshkruar nga ju. Ky vendim është tërësisht i paligjshëm", shkroi "Vita" në pjesën e komenteve të postimit të Mujës. Drejtuesit e kompanisë thanë se

punësojnë rreth 500 punëtorë dhe bashkëpunojnë me mbi 1 mijë fermerë nga të cilët e marrin qumështin.

Qumështorja "Vita" është pjesë e korporatës "Devolli Group".

Inspektimet në "Vita" nxitën reagime edhe nga figura politike opozitare, por edhe Lidhja e Bizneseve të Kosovës, që e cilësoi si goditje "direkte ndaj ekonomisë së Kosovës". "Mbyllja e një prej prodhuesve më të mëdhenj vendorë nuk është vetëm çështje e një kompanie - është goditje e drejtpërdrejtë ndaj qindra vendeve të punës, qindra fermerëve vendorë, zinxhirit të furnizimit dhe stabilitetit të tregut në Kosovë. Kjo është një goditje e rëndë ndaj prodhimit vendor dhe një sinjal jashtëzakonisht negativ për investitorët - si vendorë ashtu edhe të huaj", u tha në reagimin e Lidhjes së Bizneseve të Kosovës.

Në fund të prillit, ministri në detyrë i Bujqësisë, Armend Muja, kishte njoftuar për disa masa të ndërmarrja sa i përket produkteve të qumështit. Ai kishte thënë se produktet e qumështit duhet të etiketohen dhe të kategorizohen qartë. "Nuk do të lejohet përzjerja e qumështit të freskët me produkte që përmbajnë qumësht pluhur apo vaj palme", kishte deklaruar ai gjatë një konference për media më 28 prill.

OEK-u dhe Riinvest: Kosova duhet të përfshihet në rrjetin rajonal të gazit për të forcuar sigurinë energjetike

PRISHTINË, 3 KORRIK - Oda Ekonomike e Kosovës, në bashkëpunim me Institutin për Hulumtime Zhvillimore Riinvest, ka organizuar debatin "Gazi si burim i energjisë: Gjendja aktuale dhe perspektiva", ku u diskutuan sfidat dhe mundësitë për zhvillimin e sektorit energjetik në Kosovë.

Përfaqësues të institucioneve, biznesit, ekspertë, akademikë dhe shoqëria civile vlerësuan se vendi duhet të ndërmarrë hapa

konkretë për të diversifikuar burimet energjetike, për të zvogëluar varësinë nga importi dhe për të garantuar furnizim të qëndrueshëm me energji.

Ndër rekomandimet kryesore të debatit ishin: Përfshirja e Kosovës në rrjetin rajonal të gazit natyror dhe ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme; Rishikimi i Strategjisë së Energjisë, duke përfshirë zhvillimin e infrastrukturës së gazit dhe ndërlidhjen me projektet rajonale;

Përsheptimi i investimeve në burimet e ripërtëritshme të energjisë; Thellimi i bashkëpunimit energjetik ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë.

Oda Ekonomike e Kosovës dhe Instituti Riinvest ritheksuan se zhvillimi i infrastrukturës së gazit, diversifikimi i burimeve energjetike dhe bashkëpunimi rajonal janë kyçe për rritjen e sigurisë energjetike dhe konkurrueshmërisë së ekonomisë së Kosovës.



BE NËN DREJTIMIN E IRLANDËS: ÇFARË NDRYSHON PËR 27 VENDET ANËTARE?

Irlanda, e vendosur në skajin e Oqeanit Atlantik por njëkohësisht thellësisht europiane, ka marrë nga 1 korriku Presidencën e radhës së Këshillit të Bashkimit Europian. Kjo është hera e tetë që vendi e ushtron këtë rol që prej anëtarësimit në BE në vitin 1973. Kryeministri irlandez Micheál Martin deklaroi gjatë ceremonisë së hapjes në Dublin se Irlanda i detyron shumë zhvillimit të saj anëtarësimit në Bashkimin Europian. Sipas tij, transformimi i vendit në një ekonomi moderne dhe të hapur lidhet ngushtë me integrimin evropian.

Që nga ajo kohë, Irlanda ka kaluar një zhvillim të madh ekonomik, duke u njohur si "Tigri Keltik". Që nga viti 2018, vendi është bërë kontribuues neto në buxhetin e BE-së, ndërsa sot renditet ndër shtetet me të ardhurat më të larta për frymë në Bashkimin Evropian.

Gjatë 6 muajve të ardhshëm, Irlanda do të drejtojë mbledhjet e Këshillit të BE-së, organit kryesor vendimmarrës ku përfaqësohen 27 shtetet anëtare. Motoja e

presidencës është në gjuhën irlandeze: "Ní neart go cur le chéile", që do të thotë "Nuk ka forcë pa unitet".

Qeveria irlandeze synon të forcojë bashkëpunimin mes vendeve anëtare dhe të përqendrohet në disa fusha kryesore: rritjen e konkurrueshmërisë ekonomike, mbrojtjen e vlerave të BE-së dhe forcimin e sigurisë.

Ndër prioritetet kryesore janë: rregullimi i përdorimit të rrjeteve sociale për të rinjtë nën 16 vjeç, diskutimet për buxhetin e ri të BE-së pas vitit 2028, avancimi i Bashkimit të Tregjeve të Kapitalit dhe mbështetja për Ukrainën.

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky mori pjesë në ceremoninë e hapjes në Dublin si i ftuar nderi. Ai kërkoi forcimin e sanksioneve ndaj Rusisë, përfshirë masa kundër të ashtuquajturës "flotë në hije" dhe rrjeteve që, sipas tij, ndihmojnë Moskën në luftë.

Zelensky theksoi gjithashtu nevojën për të ndaluar kompani dhe struktura që, sipas tij, vazhdojnë të furnizojnë



industrinë ruse.

Nga ana e tij, kryeministri Micheál Martin deklaroi se çështja e eksporteve të mundshme nga Irlanda drejt Rusisë po hetohet dhe se rezultatet do t'i paraqiten Komisionit Evropian. Ai theksoi se Irlanda nuk dëshiron që asnjë produkt i saj të përdoret për qëllime ushtarake në Rusi. Irlanda gjithashtu synon të

mbështesë paketat e reja të sanksioneve të BE-së dhe përparimin e negociatave për anëtarësimin e Ukrainës në Union.

Një nga prioritetet kryesore të presidencës irlandeze është forcimi i konkurrueshmërisë së BE-së përmes thellimit të tregut të përbashkët. Qëllimi është thjeshtimi i rregullave për bizneset, ulja e burokracisë dhe

përfundimi i integritetit të tregjeve të kapitalit deri në vitin 2027.

Ministri i Financave, Simon Harris, theksoi se ky projekt do të jetë në qendër të punës së presidencës, por paralajmëroi se negociatat do të jenë të vështira, sidomos për buxhetin e ardhshëm të BE-së.

Buxheti i ri i Unionit për periudhën 2028-2035 pritet të jetë një nga temat më të ndërlikuara, pasi shtetet anëtare kanë ende qëndrime të ndryshme për kontributet financiare.

Një tjetër çështje e rëndësishme është roli i Irlandës si vend ku janë të vendosura shumë kompani të mëdha teknologjike amerikane, si Google, Apple dhe Meta.

Irlanda pritet të luajë rolin e një "ndërmjetësi të ndershem" në debatet për rregullimin e sektorit digjital dhe taksimin e kompanive teknologjike. Qeveria thekson se vendimet e BE-së duhet të balancojnë interesat ekonomike të Unionit me marrëdhëniet ndërkombëtare, veçanërisht me Shtetet e Bashkuara.

PAS FINLANDËS, EDHE LITUANIA VENDOS TË LEJOJË ARMËT BËRTHAMORE NË TERRITORIN E SAJ



Presidenti lituanes, Gitanas Nausėda, tha se udhëheqësit më të lartë politikë të vendit baltik kishin rënë dakord që një ndalim kushtetues për vendosjen e armëve bërthamore në vend duhet të hiqet.

Nausėda tha se neni 137 i kushtetutës së Lituaniës, i cili ndalon në mënyrë të qartë vendosjen e armëve të shkatërrimit në masë dhe krijimin e bazave ushtarake të huaja në territorin lituanes, ishte bërë "i vjetëruar" dhe "i papërdorshëm", sipas një raporti nga transmetuesi shtetëror LRT. "Situata gjeopolitike po përkeqësohet. Kushtetuta jonë u shkrua kur rrethanat gjeopolitike ishin krejtësisht të ndryshme", tha Nausėda.

Vendi baltik pret një grup betejë

shumëkombëshe të NATO-s me një prani të përhershme prej deri në 5,000 ushtarësh gjermanë.

Por Lituania është gjithashtu e rrethuar nga një arsenal i aftë për armë bërthamore i vendosur në enklavën ruse të Kaliningradit dhe Bjellorusinë, aleatin më të fortë të Moskës.

Tani që udhëheqësit e partive politike të Lituaniës kanë rënë dakord në parim për të ndryshuar kushtetutën e vendit, pyetja është nëse duhet bërë ndryshimi nëpërmjet një votimi parlamentar, siç bëri Finlanda, apo duhet të mbahet një referendum.

Finlanda votoi së fundmi për të hequr ndalimin e saj të gjatë të armëve bërthamore, duke i lejuar vendit të marrë, transportojë dhe lehtësojë

lëvizjen e armëve bërthamore në territorin e saj si pjesë e mbrojtjes aleate. Masa e re hyri në fuqi të mërkurën.

Finlanda njoftoi planet për të bashkëpunuar me firmën amerikane të mbrojtjes Lockheed Martin për të ndërtuar qendrën e parë të mirëmbajtjes në Evropë për sistemet e raketave me lëshim të shumëfishtë (MLRS) në Tampere.

Lajmi shkaktoi zemërim dhe kërcënime në Rusi, me nënkryetarin e parë të Komitetit të Mbrojtjes të Dumës Shtetërore Ruse, Aleksey Zhuravlyov, i cili akuzoi Finlandën se po bëhet "një Ukrainë e dytë" dhe kërcënoi hapur se Moska ka fuqinë ushtarake për të shkatërruar gjysmën e vendit.

KUBA THOTË SE NUK KA FRIKË NGA NJË KONFLIKT I MUNDSHËM ME SHBA-në

Presidenti kuban Miguel Diaz-Canel tha se Kuba "nuk ka frikë" nga Shtetet e Bashkuara dhe është gati t'i rezistojë presionit, përfshirë një konflikt të mundshëm ushtarak.

Diaz-Canel tha se Kuba po "përgatitet" për skenarë të ndryshëm, përfshirë mundësinë e luftës, duke theksuar se vendi "nuk dëshiron konflikt, por as nuk ka frikë prej tij".

"Ne nuk duam luftë, por nuk kemi frikë prej saj dhe po përgatitemi të mos habitemi ose të mos mposhtemi", tha presidenti kuban në një intervistë me Sky News, duke

shtuar se vendi është gati të "mbrojë pavarësinë dhe sovranitetin e tij deri në pikën e fundit të gjakut".

Ai akuzoi Uashingtonin për përdorimin e retorikës dhe mesazheve politike si mjet presioni, frikësimi dhe destabilizimi të Kubës, duke theksuar se kjo është një "fushatë e udhëhequr nga media dhe presion psikologjik".

Sipas tij, Kuba është një "vend paqësor që nuk përbën kërcënim për askënd", por nuk do të pranohet, siç deklaroi ai, humbjen e sovranitetit.

Siç shkruan Mirror, tensionet

midis Havanës dhe Uashingtonit janë rritur pas lëvizjeve të administratës së Presidentit të SHBA-së Donald Trump, përfshirë bllokadën energjetike e cila, sipas zyrtarëve kubanë, ka çuar në pasoja të rënda për ekonominë tashmë të dobësuar të ishullit, duke përfshirë mungesa të energjisë elektrike, ushqimit dhe karburantit.

Zyrtarët kubanë pretendojnë se ndërprerjet e përditshme të energjisë elektrike që zgjasin me orë të tëra dhe mungesat e produkteve bazë kanë përkeqësuar jetën e përditshme të popullsisë.





“Fshesë” te Feronikeli, largohen 14 futbollistë

DRENAS, 3 KORRIK - Feronikeli '74 ka nisur riorganizimin e skuadrës, duke zyrtarizuar largimin e 14 futbollistëve me marrëveshje të dyanshme. Klubi nga Drenasi ka njoftuar se bashkëpunimi ka përfunduar me Arbios Thaqin, Arion Ymerin, Muhamed

Llapashticën, Diellor Besenin, Endrit Kastratin, Samir Sadriun, Jon Qorin, Bejtë Rexhepin, Adonis Qorin, Arlind Krasniqin, Ardit Miftarin, Januz Miftarin, Abdeen Abdul dhe Mohamed Ibrahim Ngom. Përmes një njoftimi zyrtar, Feronikeli ka falënderuar

futbollistët për kontributin e dhënë gjatë kohës sa ishin pjesë e klubit. “Në emër të gjithë klubit, ju falënderojmë sinqerisht për profesionalizmin, përkushtimin dhe respektin që keni treguar gjatë gjithë kohës sa ishit pjesë e jona”, është thënë në njoftimin e klubit.

Feronikeli ka vlerësuar kontributin e secilit lojtar dhe u ka uruar atyre shëndet, suksese dhe arritje në vazhdim të karrierës. “Dyert e klubit tonë do të mbeten gjithmonë të hapura për secilin prej jush”, është thënë në njoftimin e Feronikelit.



FFK-ja FTON FUTBOLLISTËT NGA DIASPORA TË STËRVITEN NË KAMPIN NACIONAL NË HAJVALI

PRISHTINË, 3 KORRIK - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka ftuar të gjithë futbollistët dhe futbollistët nga diaspora, të cilët gjatë pushimeve verore qëndrojnë në Kosovë, ta shfrytëzojnë Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali për zhvillimin e seancave stërvitore. Sipas njoftimit të FFK-së, dyert e Kampit Nacional janë të hapura për sportistët e të gjitha kategorive, pavarësisht ligës ku aktivizohen apo kombëtares që përfaqësojnë.

“Pavarësisht se në cilën ligë

aktivizohen apo cilën kombëtare e përfaqësojnë, Kampi Nacional është i hapur për të gjithë ata që këto ditë vere i kalojnë pranë familjeve të tyre në Kosovë. Synimi ynë është t’ju ofrojmë kushte profesionale stërvitore dhe t’i mirëpresim gjithmonë në shtëpinë e futbollit të Kosovës”, është thënë në njoftimin e FFK-së.

FFK-ja ka bërë me dije se të interesuarit duhet të dërgojnë një kërkesë në adresën elektronike: enismehmeti@ffk-kosova.com, duke specifikuar



datën ose datat e dëshiruara për stërvitje, orarin e preferuar, numrin e pjesëmarrësve dhe vitin e lindjes. Federata ka njoftuar gjithashtu se për grupet me më shumë se pesë pjesëmarrës do të ofrojë asistencë profesionale përmes trajnerëve të saj, në përputhje me orarin dhe kapacitetet e Kampit Nacional. Në fund, FFK-ja ka shprehur gatishmërinë për t’i mirëpritur të gjithë futbollistët nga diaspora dhe u ka uruar atyre pushime sa më të këndshme në Kosovë.

XHAKA: JUBILEU I 150-të ME ZVICRËN BËHET EDHE MË I VEÇANTË ME KUALIFIKIMIN

Vancouver, 3 korrik - Kapiteni i Zvicrës, Granit Xhaka, e ka cilësuar si një moment të veçantë kualifikimin në 1/8 e finales së Kupës së Botës, pasi ndeshja ndaj Algjerisë ishte edhe paraqitja e tij e 150-të me fanellën e kombëtares zvicerane. Mesfushori shqiptar është shprehur se ndihet i privilegjuar që ka përfaqësuar Zvicrën për kaq shumë vite.

“Është një privilegj të kem veshur këtë fanellë për herë të 150-të. Ky vend, ku kam lindur dhe jam rritur, i ka dhënë shumë familjes sime. Shpresoj që kjo të mos jetë ndeshja ime e fundit”, ka deklaruar Xhaka.

Ai ka zbuluar se para ndeshjes u kishte kërkuar bashkëlojtarëve ta bënin jubileun edhe më të veçantë duke siguruar kualifikimin, gjë që skuadra e realizoi me sukses.

Duke komentuar fitoren 2:0 ndaj Algjerisë, Xhaka është shprehur i kënaqur me paraqitjen e ekipit.



“Pjesa e parë ishte e mirë, ndërsa e dyta shumë e mirë. Në ndeshjet me eliminim direkt nuk ka rëndësi si luan, por që të

kualifikohesh. Dhe këtë e arritëm”, ka thënë ai. Kapiteni zviceran ka vlerësuar edhe punën e skuadrës në fazën mbrojtëse, duke theksuar disiplinën dhe forcën kolektive pas tri ndeshjeve të mëparshme në të cilat Zvicra kishte pësuar gol.

Xhaka ka lavdëruar edhe talentin e ri Johan Manzambi, duke vlerësuar mentalitetin dhe potencialin e tij. “Ai është në rrugën e duhur për t’u bërë një lojtar shumë, shumë i madh. Edhe sot na ndihmoi të shënonim. Më pëlqen mentaliteti i tij, sepse dëshiron të përmirësohet çdo ditë. Kur e ke këtë qasje në një moshë kaq të re, mund të arrish gjëra të mëdha”, është shprehur Xhaka. Në fund, ai ka falënderuar tifozët zviceranë për mbështetjen, veçanërisht ata që u zgjuan herët për ta ndjekur ndeshjen, duke e cilësuar përkrahjen e tyre si motiv shtesë për ekipin.

Fund i një epoke: Modriqi përletet në lamtumirën e tij nga Botërori me Kroacinë

TORONTO, 3 KORRIK - Luka Modriqi është përlet në fund të ndeshjes, ndërsa udhëtimi i Kombëtares së Kroacisë në Kupën e Botës ka përfunduar me eliminim nga Portugalia.

Mesfushori veteran, një nga legjendat më të mëdha të futbollit modern është parë dukshëm i emocionuar pas fishkëllimës së fundit, duke falënderuar tifozët për mbështetjen dhe duke përshëndetur një karrierë të jashtëzakonshme në skenën më të madhe të futbollit botëror. Në atë që mund të jetë një nga momentet e fundit të tij në Kupën e Botës, Modriqi ka përmbyllur një tjetër kapitull të madh të karrierës së tij, pasi kjo ishte paraqitja e tij e pestë në Botëror,



duke luajtur në edicionet 2006, 2014, 2018, 2022 dhe 2026. Një fund emocional për një legjendë që ka lënë gjurmë të pashlyshme në historinë e futbollit ndërkombëtar. Modriqi pritet t’i japë fund karrierës me Kroacinë pas 202 ndeshjeve të zhvilluara, ndërsa suksesi më i madh i tij mbetet vendi i dytë në Kupën e Botës në vitin 2018.

Kosova humb shansin për kualifikim në “Eurobasket 2029”

Prizren, 3 korrik - Kombëtarja e Kosovës ka pësuar një tjetër disfatë në kuadër të parakualifikimeve për “Eurobasket 2029”, duke u mposhtur nga Shqipëria në një

ndeshje ku humbur edhe shanset për kualifikim në raundin e dytë. Në përballjen e zhvilluar në palestrën thuajse të zbrazët “Sezai Surroi” në Prizren,

Kosova është mposhtur me rezultat 89-82 nga Shqipëria. Me këtë humbje, përfaqësuesja e Kosovës ka humbur edhe gjasat për të avancuar më tej në garën

kualifikuese, duke mbetur me vetëm një ndeshje të mbetur në Grupin C. Ndeshjen e fundit, Kosova do ta zhvillojë më 5 korrik në udhëtim ndaj Sllovakisë.





Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT - Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nenit 18 dhe nenin 22 të Rregullores Nr. 13/25 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të miratuar nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L "Përparimi" Sh. A e duke u bazuar në vendimin e datës 03.07.2026 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L "Përparimi" Sh. A., me datë 03.07.2026, shpall:

KONKURS PUBLIK I JASHTËM

I. Titulli: Mirëmbajtës i Hapësirave Publike

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) muaj, nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Shkolla fillore

Përvoja e punës: Nuk kërkohet përvojë pune

I raporton: Udhëheqësit të Njesisë së Mirëmbajtjes të Hapësirave Publike

Koeficienti i pagës: 623.29 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Kujdeset për ruajtjen, pastrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve të qytetit.
- Kujdeset për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e rrethojave të parqeve.
- Kujdeset për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e inventarit për rekreacion dhe pushim në parqe.
- Kujdeset për mirëmbajtjen e stazave dhe gjelbërimit në parqe.
- Mbjell, kultivon lule dhe bari, si dhe kositë dhe rregullon ato, duke përfshirë ujitjen dhe freskimin.
- Kultivon, mirëmban dhe krasitë drunjtë në pronësi publike.
- Mban higjienën dhe pastrimin e parqeve dhe shesheve.
- Bën hapjen e varrezave.
- Kujdeset për mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve, martirëve, lapidarëve, përmendoreve, pllakave përkujtimore, të cilat menaxhohen nga komuna.
- Bën fshirjen e oxhaqeve në objektet publike dhe private, në bazë të tarifave të përcaktuara paraprakisht.
- Për punën e tij i përgjigjet Udhëheqësit të Njesisë të Mirëmbajtjes së Hapësirave Publike.
- Kryen dhe punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes.

➤ Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët.

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojnë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

➤ Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

- Testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Intervista me gojë deri në njëzetë (20) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

➤ Dokumentet që kërkohet para themelimit të marrëdhënies së punës:

- Vërtetimi për zotësinë e plotë të veprimit.
- Certifikatën shëndetësore.

➤ Periudha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njëjtit. Shpallja është e hapur nga data 06.07.2026 deri me datë 20.07.2026 ora 16:00.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 27.07.2026.
- Afati për ankesë kundër njoftimeve për verifikimin paraprak të kandidatëve nga data 28.07.2026 deri me datë 30.07.2026.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 06.08.2026.
- Afati për ankesë ndaj njoftimeve për rezultatet e testit me shkrim nga data 07.08.2026 deri me datë 10.08.2026.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 13.08.2026.
- Afati për ankesë nga data 14.08.2026 deri me datë 17.08.2026.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm dhe lidhja e marrëdhënies bëhet më së largu 28.08.2026.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo, dhe varësisht nga puna e komisionit vlerësues, dhe departamentit të personelit. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

➤ Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtrri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Departamenti i Personelit duke zbatuar nenin 8 par. 3 të Udhëzimit MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, do tu ofrojë sqarime të nevojshme për kandidatët në lidhje me kriteret e konkursit publik, dhe do tu asistoj dhe tu jap udhëzimet e nevojshme për aplikim me anë të adresës elektronike.

Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: hrperparimi@gmail.com.

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik, dhe secili nga kandidatët do të njoftohet individualisht.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

➤ Sqarim

Ndërmarrja ka për qëllim të sqarojë çështjen e termeve të përdorura në aspektin gjinor, meqë rast fjalët dhe titujt e një gjinie përfshijnë edhe gjininë tjetër.

➤ Përfundim

N.P.L "Përparimi" Sh. A në Vushtrri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe inkurajohen komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me afilësi të kufizuar, dhe gjinia më pak e përfaqësuar që të aplikojnë.

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Na osnovu člana 8, člana 10 podstav 2.2 i člana 15 Zakona o radu br. 03/L-212 objavljenog u Službenom listu Republike Kosovo dana 01.12.2010. godine, u vezi sa članom 7 Administrativnog uputstva MFRT - br. 01/2024 o uređivanju konkursnih procedura u javnom sektoru koji je deo Zakona o radu br. 03/L-212 objavljenog u Službenom listu Republike Kosovo dana 31.10.2017. godine, kao i člana 18 i člana 22 Pravilnika br. 13/25 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta usvojenog od strane Odbora direktora L.J.P. „Përparimi“ a.d., a oslanjajući se na odluku **03.07.2026.** godine Glavnog izvršnog direktora, L.J.P. „Përparimi“ a.d., dana **03.07.2026** godine, objavljuje:

JAVNI KONKURS

I. Naziv: Održavalac javnih prostora

Broj izvršilaca: 1

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Period zaposlenja: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja

Stručna sprema: Osnovna škola

Radno iskustvo: Nije potrebno radno iskustvo

Podređenost: Rukovodiocu Jedinice za održavanje javnih prostora

Koeficijent plate: 623.9 Euro Bruto

Opis poslova i odgovornosti:

- Brine o očuvanju, čišćenju i održavanju gradskih parkova.
- Brine o očuvanju i održavanju ograde parkova.
- Brine o očuvanju i održavanju inventara za rekreaciju i odmor u parkovima.
- Brine o održavanju staza i zelenih površina u parkovima.
- Sadnja, gajenje eveča i biljaka, kao i košenje i uređivanje istih, uključujući zalivanje i osvežavanje.
- Gaji, održava i uređuje drveće na javnom vlasništvu.
- Održava higijenu i čistoću parkova i trgova.
- Vršiti otvaranje grobnica.
- Brine o održavanju grobnica za heroje, mučenike, spomenike, memorijalne ploče, koje upravlja lokalna samouprava.
- Vršiti čišćenje jama na javnim i privatnim objektima, na osnovu unapred utvrđenih tarifa.
- Za svoj rad odgovara Rukovodiocu Jedinice za održavanje javnih prostora.
- Vršiti druge poslove po nalogu uprave preduzeća.

Uz prijavu je potrebno priložiti sljedeće:

- Prijavni obrazac za NPL "Përparimi" Sh. A - Vučitrn. (skenirano);
- Potvrde o školskoj spremi (skenirane);
- Ekstrakt rođenja; (sertifikat izdat online na platformi e-Kosova će biti prihvaćen);
- Potvrda o krivičnoj osudi koju je izdao Sudski savet Kosova, da nema krivičnih osuda u centralnoj krivičnoj evidenciji Republike Kosovo (uverenje izdato online na platformi e-Kosova će biti prihvaćeno);
- Dokaz o radnom iskustvu (skenirano) (nije obavezno);
- Kopija lične karte (skenirana);

➤ Opšti kriterijumi koje svi kandidati moraju ispuniti

- Budite državljanin Republike Kosovo.
- Imaju puni kapacitet za djelovanje.
- Da vlada najmanje jednim od službenih jezika u skladu sa Zakonom o jezicima.

➤ Način vrednovanja kandidata.

- Pismeni test do sedamdeset (70) bodova.
- Usmeni intervju do dvadeset (20) bodova
- CV kandidata do deset (10) bodova.

➤ Dokumenti koji se zahtevaju pre zasnivanja radnog odnosa:

- Uverenje o punoj poslovnoj sposobnosti.
- Lekarsko uverenje.

➤ Rok za prijavu kandidata i okvirni kalendar procedure zapošljavanja.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana njegovog objavljivanja. Oglas je otvoren od **06.07.2026** godine do **20.07.2026** godine u 16:00 časova.

Okvirni kalendar procedure regrutovanja:

- Preliminarna verifikacija aplikacija kandidata najkasnije do **27.07.2026** godine.
- Rok za žalbu protiv obaveštenja o preliminarnoj verifikaciji kandidata od **28.07.2026** do **30.07.2026** godine.

- Period kada će kandidati pristupiti pismenom testu, i kada će se izvršiti njihovo ocenjivanje biće najkasnije do **06.08.2026** godine.
- Rok za žalbu na obaveštenja o rezultatima pismenog testa od **07.08.2026** do **10.08.2026** godine.
- Period kada će kandidati pristupiti usmenom intervjuu, i kada će se izvršiti njihovo ocenjivanje biće najkasnije do **13.08.2026** godine.
- Rok za žalbu od **14.08.2026** do **17.08.2026** godine.
- Objavljivanje konačnih rezultata u vezi sa uspešnim kandidatom je najkasnije **28.08.2026** godine.

Okvirni kalendar postupka zapošljavanja može biti duži ili kraći, u zavisnosti od toga da li je pritužba podneta ili ne, a u zavisnosti od rada komisije za evaluaciju i kadrovske službe. U svim slučajevima kada se žalba podnese u bilo kojoj fazi postupka zapošljavanja, pritužba će imati suspenzivno dejstvo, sve dok istu ne razmotri Komisija za žalbe.

➤ Kako se prijaviti i komunicirati sa kandidatima

Zainteresovani kandidati mogu dobiti prijavni formular u Arhivu N.P.L "Peparimi" Sh. A u gradu Vučitrnu, ul. "Gjergj Kastriot Skënderbeu" br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – ogranak u Vučitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kadrovska služba za sprovođenje člana 8 st. 3 Uputstva MFPT-br. 01/2024 za Uređenje konkursnih procedura u javnom sektoru, daće potrebna pojašnjenja za kandidate u vezi sa kriterijumima javnog konkursa, te pomoći i dati potrebna uputstva za prijavu putem elektronske adrese.

Podnošenje prijave sa svom dokumentacijom traženom u ovom javnom oglasu vrši se isključivo putem elektronske adrese i to: hrperparimi@gmail.com. Sva komunikacija u toku postupka javnog nadmetanja odvijaće se putem elektronske komunikacije, a svaki od kandidata će biti pojedinačno obaviješten.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene.

➤ Objasnjenje

Preduzeće ima za cilj da pojasni pitanje termina koji se koriste u rodnom aspektu, pri čemu reči i titule jednog roda uključuju i drugi rod.

➤ **ZAKLJUČAK** NPL "Peparimi" Sh. A u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Republike Kosovo, a nevećinske zajednice i njihovi pripadnici, osobe sa invaliditetom i nedovoljno zastupljeni pol se podstiču da se prijave.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

Duke u bazuar në paragrafin 8 të nenit 7 të Ligjit Nr.08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me operatorin "Sharr Cem" Sh.p.k. kërkesa për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Integruar me Nr.Prot. 26/1429/MMPHI/224/DMM, për veprimtarinë: Ndryshim në impiant, shfrytëzimi i lëndëve djegëse alternative (LDA) nga gomat e përdorura të copëtuara, kodi 160103, mbeturina jo të rrezikshme, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 29.07.2026, në ora: 10:00, në hapësirat e ELEKTRA LLC, salla e takimeve, Hani i Elezit (https://maps.app.goo.gl/kqJE8QzdeFfJArSC6?g_st=aw), do të organizohet debat publik nga operatori "Sharr Cem" Sh.p.k. kërkesa për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Integruar me Nr.Prot. 26/1429/MMPHI/224/DMM, për veprimtarinë: Ndryshim në impiant, shfrytëzimi i lëndëve djegëse alternative (LDA) nga gomat e përdorura të copëtuara, kodi 160103, mbeturina jo të rrezikshme, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

ID: <https://us04web.zoom.us/j/3422360809>

Passcode: 617875

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPH-së, për komente të publikut:

<https://mmphi.rks.gov.net/Document/Announcements?year=2026&pageNumber=3>

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,
"SharrCem" Sh.p.k.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Eli Fruit" SH.P.K. pronar Jakup Murati me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811989493 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavajte se svi klienti da drustvo sa "Eli Fruit" D.O.O. Jakup Murati Gnjlane donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811989493 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Eli Fruit" L.L.C. with owner Jakup Murati with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 811989493 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Leart Vehapi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Luciano Motroni" Prizren.
- Sali Voca shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të Lartë Teknikë "Arkitekt Sinani" ish shkolla e mesme "Boris Kidric".
- Shemsi Zeneli B.I D.P.H. Koshare 1999 shpalle të pavlefshme certifikatën e biznesit me nui: 810203430.
- Adizo SH.PK. me nr. 812421460 bënë zvogëlim të kapitalit lëshuar nga ARBK.
- Jetmir Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m. profesionale "Gjon Nikoll Kazazi" Gjakovë.
- Vlora I. Gashi B.I. Rogovë shpall të humbur numrin unik identifikues 811865552 lëshuar nga ARBK
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



Bazuar në nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Paneli për përzgjedhjen e dy anëtarëve joekzekutivë të Bordit të Bankës Qendrore, me datën 06 Korrik 2026 publikon:

Shpallje

Për plotësimin e dy pozitave për anëtarë joekzekutivë të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

1. Profili i kërkuar i kandidatëve:

- Të jetë shtetas/e i/e Kosovës;
- Të jetë me integritet;
- Të ketë diplomë universitare për studimet themelore;
- Të ketë minimum dhjetë (10) vite përvojë profesionale ose akademike në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitetit apo çështjeve juridike;
- Të ketë njohuri në zhvillimin dhe implementimin e politikave të rëndësishme të ndërlidhura me misionin, objektivat dhe detyrat e BQK-së;
- Të përmbushë kërkesat nga neni 40 i Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;

2. Përparësi do të kenë kandidatët që kanë:

- Përvojë në qeverisje korporative, në pozita të larta drejtuese ose vendimmarrëse;
- Përvojë si anëtar bordi, komitete ose organe kolegjinale;
- Certifikime profesionale relevante të ndërlidhura me mandatin e BQK-së;
- Njohuri të gjuhës angleze dhe gjuhëve tjera.

3. Dokumentet e kërkua për pozitën në fjalë:

- CV;
- Letër motivuese ku paraqitet qartazi ndërlidhja e profilit të kandidatit/es me kërkesat e pozitës së shpallur;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja valide e ID-së (e lëshuar nga institucionet e Republikës së Kosovës);
- Diplomat e noterizuara, ndërsa për diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës, edhe nostrifikimet e tyre të noterizuara në Republikën e Kosovës;
- Dëshmi mbi përvojën e punës (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar përvojën e punës, pa cënuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Certifikatën nga Gjykata kompetente, e cila dëshmon se kandidati/ja nuk ka qenë asnjëherë subjekt i ndonjë vepre penale (certifikatë kjo jo më e vjetër se 3 muaj - mund të jetë e lëshuar elektronikisht);
- Deklaratën nën betim të nënshkruar, (e bashkëngjitur në shpallje);
- www.bqk-kos.org/shpalljet/konkurse-te-punes/
- Dëshmi mbi plotësimin e kërkesave të preferueshme (përparësisë) sipas pikës 2 të kësaj shpalljeje;
- Rekomandimet dhe referencat e mundshme (opsionale).

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e lartcekur përmes email adresës vijuese: paneli@bqk-kos.org

Dokumentacioni i pakompletuar ose i dorëzuar pas afatit nuk do të shqyrtohet.

Afati i fundit për aplikim është **27 korrik 2026**.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur nga ana e Panelit do të ftohen për intervistë.

Emërimi do të jetë për një mandat pesëvjeçar duke filluar nga data e emërimit.

Lista e kandidatëve që kualifikohen nga ana e Panelit do t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës i cili do të përzgjedhë dy individë. Miratimi dhe emërimi për këtë pozitë do të bëhet nga Presidenti/ja i/e Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 84.27 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 38.2 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Emrat e kandidatëve të cilët Paneli i dërgon në Kuvendin e Kosovës dhe Qeveri (për t'u përzgjedhur) do të publikohen në faqen e internetit të Bankës Qendrore. Me aplikimin për pozitën e anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore, konsiderohet se kandidati/ja ka dhënë pëlqimin për publikimin në fjalë.



Na osnovu člana 38 Zakona br. 03/L-209 o Centralnoj banci Republike Kosovo, Panel za izbor dva neizvršna člana Upravnog odbora Centralne banke, od 06. jula 2026. godine, objavljuje:

Oglas

Za popunjavanje dve pozicije za neizvršne članove Upravnog odbora Centralne banke Republike Kosovo

1. Potreban profil kandidata/kandidatkinje:

- Da je građanin/državljanica Kosova;
- Da je osoba od integriteta;
- Da poseduje univerzitetsku diplomu osnovnih studija;
- Da ima najmanje deset (10) godina stručnog ili akademskog iskustva u oblastima ekonomije, finansija, bankarstva, računovodstva ili pravnih pitanja;
- Da poseduje znanje o razvoju i sprovođenju važnih politika vezanih za misiju, ciljeve i zadatke CBK;
- Da ispunjava zahteve propisane članom 40 Zakona br. 03/L-209 o Centralnoj banci Republike Kosovo;

2. Prednost će biti data kandidatima koji imaju:

- Iskustvo u korporativnom upravljanju, na višim rukovodećim ili pozicijama donošenja odluka;
- Iskustvo kao član odbora, komiteta ili kolegijalnih tela;
- Relevantne stručne sertifikacije vezane za mandat CBK;
- Znanje engleskog i drugih jezika.

3. Potrebna dokumenta za objavlvenu poziciju:

- CV;
- Propratno pismo koje jasno pokazuje vezu između profila kandidata/kandidatkinje i zahteva oglasene pozicije;
- Dokaz o identitetu/važeća kopija lične karte (izdata od strane institucija Republike Kosovo);
- Overene diplome, dok je za diplome stečene van Republike Kosovo potrebna i njihova nostrifikacija, overena u Republici Kosovo;
- Dokaz o radnom iskustvu (kopije ugovora o radu, potvrde poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe kao dokaz o radnom iskustvu, uz poštovanje važećih propisa o zaštiti podataka o ličnosti).
- Potvrda nadležnog suda kojom se dokazuje da kandidat/kandidatkinja nikada nije bio/la osuđen/a za krivično delo (ova potvrda ne sme biti starija od 3 meseca - može se izdati elektronski);
- Potpisana izjava pod zakletvom (priložena uz oglas); www.bqk-kos.org/shpalljet/konkurse-te-punes/?lang=sr
- Dokaz o ispunjenosti poželjnih uslova (prednosti) iz tačke 2 ovog oglasa;
- Preporuke i moguće reference (opciono).

Zainteresovani kandidati treba da dostave gore navedenu dokumentaciju putem sledeće imejl adrese: panel@bqk-kos.org

Nepotpuna dokumentacija ili dokumentacija dostavljena nakon roka neće biti razmatrana.

Krajnji rok za podnošenje prijave je **27. jul 2026**.

Samo kandidati koje odabere Panel biće pozvani na razgovor.

Imenovanje će se izvršiti na mandat od pet godina, počev od dana imenovanja.

Lista kandidata koje je kvalifikovao Panel biće poslata Skupštini Republike Kosovo, koja će izabrati dve osobe. Odobrenje i imenovanje za ovu poziciju izvršiće predsednik/predsednica Republike Kosovo u skladu sa članom 84.27 Ustava Republike Kosovo i članom 38.2 Zakona br. 03/L-209 o Centralnoj banci Republike Kosovo

Imena kandidata koje Panel pošalje Skupštini Kosova i Vladi (radi izbora) biće objavljena na web stranici Centralne banke. Podnošenjem prijave za poziciju neizvršnog člana Odbora Centralne banke smatra se da je kandidat dao saglasnost za navedena objavljivanja.



TRADITË QË NGA 1992

